

VENDIM
Nr. 828, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, fjala “... kalendarike ...” zëvendësohet me “... pune ...”.
2. Në kreun I bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
 - i. Në shkronjën “i”, të pikës 1.1, pas fjalës “... informacion ...” shtohet “... i detajuar ...”;
 - ii. Shkronja “j” e pikës 1.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“j) Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti;”;
 - iii. Paragrafi i fundit i pikës 1.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Raporti paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik, i certifikuar në përputhje me këtë ligj.”;
 - iv. Pas pikës 1.4 shtohet pika 1.5, me këtë përmbajtje:
“1.5 Prokurë për autorizimin e aplikuesit kur nuk është i njëjtë me zhvilluesin”.
 - b) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:
 - “3. Ministria, me marrjen e aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi është në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij kreu dhe ia përcjell jo më vonë se 2 (dy) ditë pune Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke e shoqëruar me rekomandimin përkatës.
 4. AKM-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit shoqëruar, shqyrton kërkesën, bazuar edhe në rekomandimin e ministrisë, dhe në rast se konstaton se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit “e-Albania”, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e njoftimit.”.
- c) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:
 - “4/1. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit “e-Albania” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.
 - 4/2. AKM-ja, kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditë pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve pune:
 - a) ministrive të linjës, në varësi të projektit;
 - b) drejtorive teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;

c) institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

ç) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.”

ç) Pikat 5 e 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të njësia/të e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e aplikimit.”

“7. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 4/2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës dhe brenda 22 (njëzet e dy) ditëve pune nga marrja e aplikimit, merr vendimin për VNM-në paraprake ose vendos që projekti t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, sipas formatit të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi, ia përcjell vendimin zhvilluesit, duke informuar edhe ministrinë, si dhe e publikon në faqen e saj elektronike.”

d) Pika 11 shfuqizohet.

dh) Pika 12 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“12. Afati maksimal për dërgimin e vendimit të zhvilluesi është 24 (njëzet e katër) ditë pune nga aplikimi pranë ministrisë. Afati për plotësimin e dokumentacionit sipas pikave 4 dhe 9, të këtij kreu, nuk llogaritet në afatin maksimal. Në rast se zhvilluesi nuk plotëson dokumentacionin/informacionin brenda afateve të përcaktuara në pikën 9, nënkupton që zhvilluesi ka hequr dorë nga aplikimi për VNM-në paraprake.”

3. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

i. Në shkronjën “j”, të pikës 1.1, pas fjalës “... informacion ...” shtohet “... i detajuar ...”;

ii. Shkronja “j” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“j) Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti”;

iii. Fjalja hyrëse e pikës 1.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.2 Informacioni për ndërveprimin me mjedisin të projektit të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik, i certifikuar në përputhje me këtë ligj, dhe përmban:”;

iv. Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.3 Prokurë për autorizimin e aplikuesit kur nuk është i njëjtë me zhvilluesin.”

b) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Ministria, me marrjen e aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi është në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij kreu dhe ia përcjell jo më vonë se 2 (dy) ditë pune Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke e shoqëruar me rekomandimin përkatës.

4. AKM-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit shoqëruar, shqyrton kërkesën bazuar edhe në rekomandimin e ministrisë dhe, në rast se konstaton se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit “e-Albania”, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e njoftimit.”

c) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit “e-Albania” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.

4/2. AKM-ja, kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve pune:

a) ministrive të linjës, në varësi të projektit;

b) drejtorive teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;
c) institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

ç) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.”.

ç) Pikat 5 dhe 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik te njësia/të e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e aplikimit.”.

“7. Afati maksimal nga marrja e njoftimit, sipas pikës 1, të këtij kreu, deri në njoftimin nëpërmjet sistemit elektronik të zhvilluesit, sipas pikës 6, të këtij kreu, është 25 ditë pune. Afati për plotësimin e dokumentacionit sipas pikës 4 të këtij kreu nuk llogaritet në afatin maksimal.”.

d) Në pikën 10 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Raportin e thelluar të VNM-së, të nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik, i certifikuar në përputhje me këtë ligj.”.

ii. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) Prokurë për autorizimin e aplikuesit kur nuk është i njëjtë me zhvilluesin”;

dh) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Ministria, me marrjen e aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi është në përputhje me kërkesat e pikës 10 të këtij kreu dhe ia përcjell brenda 3 (tri) ditëve pune Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke e shoqëruar me rekomandimin përkatës.”.

4. Në kreun III bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikat 2 dhe 4, togfjalëshi “... brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ...” zëvendësohet me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve ...”.

b) Në fund të shkronjës “c”, të pikës 3, shtohen fjalët “... në rast se ka filluar zbatim.”.

II. Për të gjitha kërkesat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi për t’u pajisur me VNM paraprake dhe deklaratë mjedisore zbatohen dispozitat ligjore në fuqi në kohën e aplikimit.

III. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama